



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01 nr 352-27269/19
Date 28.06.2019

KONTRATA PUBLIKE nr. 44-2019

, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; Nr Bisnesi 0700032, Nr Fiskal 600219366 , qe perfaqesohet nga Menaxheri i Prokurimit z. Abaz Foniqi

Dhe

ALTICOM SHPK NGA KLINA , , , ne tekstin e metejme kontraktuesi me numer biznesi dhe numer fiskal 811242700 , me perfaqesues pronar z. ENVER KALLUDRA

ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

NDERTIMI I KANALIZIMIT LOT 4- NE LAGJE TE QYTETIT

me numër identifikues: 634-19-2514-5-2-1/INT.634-19-034-521

Neni 1

Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

2

PUNET QE DUHET TE KRYHEN KONFORM STANDARDEVE TE KERKUARA NE TENDER DHE ATYRE TE DHENA N OFERTEN E GRUPIT TE O.E.



Nr. i art.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	CMIMI PA TVSH	VLERA PA TVSH
1	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e detektimit me aparatura elektronike për instalime nëntokësore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërtimit (rrjeti elektrik, rrjeti i ujësjellësit, etj)				
		TOTAL	558.00	0.08	44.64
2	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rrjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kaloj rrjeti i kanalizimit fekal si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik	M	558.00	0.08	44.64
3	Demolimi i gypave të ndryshëm ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin të cilin e cakton Organi Mbikqyrës, si dhe riparimi i gypit ekzistues të ujësjellësit.	TOTAL	1.00	423.73	423.73
4	Demolimi i lëshesave prej betoni dhe materialeve tjera si dhe ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin të cilin e cakton Organi Mbikqyrës.	C	1.00	42.37	42.37
5	Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor,kyqjet individuale dhe kolektorët e grilave në kat. III-IV-V të dheut, me makinë në gjërësi sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thellësi sipas profilit gjatësor.Ne kete pozicion perfsihet edhe largimi i ujrave me pompim,transporti i dheut deri ne largesi 10 km.	M3	1116.00	0.68	758.88

	Sigurimi i kanalit nga shembja e dheut. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, sipas detalit në projekt, në të dy anët e kanalit. Sigurimi bëhet për thellësit dhe kategorinë e tokës që janë të parapara më masat e mbrojtjes në punë. Sasitë janë indikative dhe punëkryesi në bashkpunim me organin mbikqyrës vendos se ku do të aplikohen këto masa sipas standardeve për thellësi. Rrjedhimisht të dy mbajnë përgjegjësinë për këtë proces				
6	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi $\pm 1\text{cm}$.	M	558.00	0.08	44.64
7	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16mm në fundin e kanalit anash dhe mbi gypa	M2	558.00	0.08	44.64
8	Mbulimi i kanalit me material natyror guror, me ngjeshmeri 40MN/m ²	M3	217.62	2.54	552.75
9	Transporti i materialit të tepërt deri në deponi 10 km te percaktuar nga organi mbikqyrës.	M3	870.00	1.69	1.470.30
10	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar HDPE SN8 për kolektorin kryesor FI250	M3	1116.00	0.42	468.72
11	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C- 20/25 t=20cm, dhe gjerësi të pllakes (120x120) cm.	M	558.00	5.08	2.834.64
12	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit	m ³	8.06	12.71	102.44
13	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø1000/1000mm (elemente të parafabrikuara)	m ³	3.30	12.71	41.94
14	Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për puseta prej betonit Ø1000/700/600mm (elemente të parafabrikuara)	m'	56.00	27.12	1.518.72
15	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø20 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive	copë	28.00	21.19	593.32
16	Furnizimi, transporti, dhe montimi i kapakëve prej materialit metalik gize me aftësi mbajtëse 40 ton.	copë	168.00	0.42	70.56
17	Furnizimi, transporti, montimi dhe kapakëve prej betoni te armuar, trashësi t=10cm, prej betonarmesë C-20/25	copë	25.00	55.08	1.377.00
18			3.00	12.71	38.13

19	Furnizimi dhe montimi-vendosja e gypit metalik Ø350mm, me gjatesi L=10m' per vendosjen e gypit PEHD250, ne kete pozicion perfshihet edhe shpimi i kanalit nen rruge.	COPE	1.00	211.86	211.86
20	Riparimi i leshesave ne rruge me gjatesi 8 m, pas demolimit	C	1.00	42.37	42.37
21	Testimi i rrjetës së kanalizimit	M	558.00	0.08	44.64
22	Hapja e kantierit që përfshin të gjitha objektet e nevojshme për përcjelljen e ndërtimit të objektit.	TOTAL	1.00	169.00	169.00
23	Riincizimi i trasës. Para fillimit të punimeve duhet të bëhet riincizimi i trasës së kanalizimit dhe definimin numerik të saj me të gjithë elemente e domosdoshëm (thyrjen horizontale, lidhjet etj)	M	1127.74	0.09	101.50
24	Gërmimi i dheut me thellësi të kanalit si në projekt dhe gjërësi mesatare 0.90m. Trasa duhet t'i përgjegjet kushteve të projektit. Gjatë gërmimit të kanalit menjëherë duhet shënuar dhe rrethuar kanalën në sipërfaqe, ashtu që çasja në kanal të jetë e sigurt. Gjithashtu duhet ndërtuar "ura" për kalimin e punëtorëve në disatncë të nevojshme. Nëse gjatë gërmimit hasim në instalim edhe objekte nëntokësore punëkryesi është i obliguar që ato t'i ruaj. Në çmim të llogaritët gërmimi, deponimi i dheut një metër larg nga kanali.	m3	2650.00	0.67	1.775.50
25	Gërmimi i dheut me thellësi të kanalit si në projekt dhe gjërësi mesatare 0.90m. Trasa duhet t'i përgjegjet kushteve të projektit. Gjatë gërmimit të kanalit menjëherë duhet shënuar dhe rrethuar kanalën në sipërfaqe, ashtu që çasja në kanal të jetë e sigurt. Gjithashtu duhet ndërtuar "ura" për kalimin e punëtorëve në disatncë të nevojshme. Nëse gjatë gërmimit hasim në instalim edhe objekte nëntokësore punëkryesi është i obliguar që ato t'i ruaj. Në çmim të llogaritët gërmimi, deponimi i dheut një metër larg nga kanali.	m3	265.00	0.67	177.55
26	Sigurimi i kanalit nga shembja. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, në të dy anët e kanalit.	m	650.00	0.08	52.00
27	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	m2	1014.97	0.08	81.20

28	Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar në deponi në vend që është caktuar nga organi mbikqyrës deri në 5km.	m3	959.00	0.42	402.78
29	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës në fundin e kanalit anash dhe mbi tub 15cm dhe ngjeshja në shtresa.	m3	365.00	2.54	927.10
30	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, për mbushjen e kanalit në pjesën ku kanalizimi punohet përgjatë konstruksionit të rrugës dhe ku kemi mbushje. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%.	m3	594.00	2.54	1.508.76
31	Mbulimi i kanalit me materialin e gërmuar nga kanali dhe ngjeshja adekuate në shtresa max 30cm.	m3	1956.00	0.42	821.52
32	Largimi i ujërave nëntokësore nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit me pompa.	TOTAL	1.00	67.00	67.00
33	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorët kryesor PESN8 F 400	m	180.00	7.62	1.371.60
34	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorët kryesor PESN8 F315	m	631.00	6.78	4.278.18
35	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorët kryesor PESN8 FI250	m	252.00	5.08	1.280.16
36	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorët kryesor PSN8 FI 200	m	65.00	6.00	390.00
37	Vendosja e shiritit sinjalizues. Shiriti duhet të vendoset min 50cm mbi gyp. Në këtë gyp duhet të shkruhet në gjuhën shqipe "KUJDES GYP I KANALIZIMIT"	M	1128.00	0.02	22.56
38	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C- 20/25 d=20cm	M3	12.54	12.71	159.38
39	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit.	M3	9.41	12.71	119.60
40	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø1000/1000mm (elemente të parafabrikuara).	COPE	78.00	27.12	2.115.36
41	Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për puseta prej betonit Ø1000/700/600mm (elemente të parafabrikuara).	COPE	32.00	21.19	678.08

42	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø19 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive.	COPE	112.00	0.42	47.04
43	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize, më aftesi mbajtëse 40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20/25.	COPE	32.00	55.08	1.762.56
44	Shpimi i rruges për kalimin e rruges së asfaltuar në vendet e caktuara sipas projektit për gypin Ø315 dhe gypin Ø250.	M	30.00	42.32	1.269.60
45	Prerja e asfaltit dhe rikthimi i asfaltit në gjendjen e mëparshme.	M2	120.00	10.18	1.221.60
46	Demolimi dhe rikthimi i kubezave të demoluara në gjendjen e mëparshme.	M2	339.00	2.54	861.06
47	Testimi i rrjetit të kanalizimit në joushueshmëri, gjithnjë sipas kushteve teknike të paraqitura për këtë lloj pune.	M	1127.74	0.08	90.22
48	Blerja, transporti dhe vendosja e gurve të thyer ose zhavor të trashë në pusët filtruese me madhësi 60-100mm.	M3	58.00	2.54	147.32
49	Hapja e kantierit që përfshin të gjitha objektet e nevojshme për përcjelljen e ndërtimit të objektit.	TOTAL	1.00	169.00	169.00
50	Pastrimi i terrenit përgjatë trases së kanalizimit nga të gjitha pengesat si shkurret, lisat dhe të tjera	M	526.00	0.08	42.08
51	Riincizimi i trasës. Para fillimit të punimeve duhet të bëhet riincizimi i trasës së kanalizimit dhe definimin numerik të saj me të gjithë elemente e domosdoshëm (thyrjen horizontale, lidhjet etj)	M	526.00	0.08	42.08
52	Gërmimi i dheut me thellësi të kanalit si në projekt dhe gjërësi mesatare 0.80-1.0m. Trasa duhet t'i përgjegjet kushteve të projektit. Gjatë gërmimit të kanalit menjëherë duhet shënuar dhe rrethuar kanalin në sipërfaqe, ashtu që çësja në kanal të jetë e sigurt. Gjithashtu duhet ndërtuar "ura" për kalimin e punëtorëve në disatncë të nevojshme. Nëse gjatë gërmimit hasim në instalim edhe objekte nëntokësore punëkryesi është i obliguar që ato t'i ruaj. Në çmim të llogaritet gërmimi, deponimi i dheut një metër larg nga kanali. ME MAKINE	M3	1672.00	0.67	1.120.24

53	Gërmimi i dheut me thellësi të kanalit si në projekt dhe gjërësi mesatare 0.80-1.0m. Trasa duhet t'i përgjegjet kushteve të projektit. Gjatë gërmimit të kanalit menjëherë duhet shënuar dhe rrethuar kanalin në sipërfaqe, ashtu që çasja në kanal të jetë e sigurt. Gjithashtu duhet ndërtuar "ura" për kalimin e punëtorëve në disatncë të nevojshme. Nëse gjatë gërmimit hasim në instalim edhe objekte nëntokësore punëkryesi është i obliguar që ato t'i ruaj. Në çmim të llogaritet gërmimi, deponimi i dheut një metër larg nga kanali. ME DORE	M3	170.00	0.67	113.90
54	Sigurimi i kanalit nga shembja. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, në të dy anët e kanalit.	M	526.00	0.08	42.08
55	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi $\pm 1\text{cm}$.	M2	526.00	0.08	42.08
56	Ngarkimi dhe transporti i dheut të gërmuar në deponi në vend që është caktuar nga organi mbikqyrës mbi 5km.	M3	903.00	0.42	379.26
57	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës në fundin e kanalit anash dhe mbi tub 15cm dhe ngjeshja në shtresa.	M3	263.00	2.54	668.02
58	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, për mbushjen e kanalit në pjesën ku kanalizimi punohet përgjate konstruksionit të rrugës dhe ku kemi mbushje. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%.	M3	640.00	2.54	1.625.60
59	Mbulimi i kanalit me materialin e gërmuar nga kanali në shtresa 30cm me ngjeshje adekuate.	M3	754.00	0.42	316.68
60	Largimi i ujërave nëntokësore nga kanali nese paraqitet gjate gropimit me pompa.	TOTAL	1.00	50.00	50.00
61	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8				
62	PESN4 Ø 315 - fekal SN8	M	368.00	6.78	2.495.04
63	PESN4 Ø 250 - fekal SN8	M	158.00	5.08	802.64
64	Vendosja e shiritit sinjalizues. Shiriti duhet të vendoset min 50cm mbi gyp. Në këtë gyp duhet të shkruhet në gjuhën shqipe "KUJDES GYP I KANALIZIMIT"	M	526.00	0.02	10.52

65	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C- 20/25 d=20cm	M3	7.06	12.71	89.73
66	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit.	M3	5.29	12.71	67.24
67	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø1000/1000mm (elemente të parafabrikuara).	COPE	45.00	27.12	1.220.40
68	Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për puseta prej betonit Ø1000/700/600mm (elemente të parafabrikuara).	COPE	18.00	21.19	381.42
69	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø19 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive.	COPE	81.00	0.42	34.02
70	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize, më aftesi mbajtëse 40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20/25.	COPE	13.00	55.08	716.04
71	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve prej betonarme. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20/25.	COPE	5.00	12.71	63.55
72	Furnizimi, transporti, montimi dhe gypit metalik Ø300 për kalimin e rruges së asfaltuar. Në çmim të llogaritet edhe shpimi i rruges në vendet e caktuara.	M	12.00	42.32	507.84
73	Heqja kubezave dhe rivendosja e kubezave prej betoni në gjendjen e mëparshme. Duhet të bëhet nivelizimi i pusetave sipas nivelit të rruges.	M2	262.00	2.95	772.90
74	Testimi i rrjetit të kanalizimit në joushueshmëri, gjithnjë sipas kushteve teknike të paraqitura për këtë lloj pune.	M	526.00	0.08	42.08
	PA VSH				44.483.61
	TVSH				8.007.05
	ME TVSH				52.490.66

VLERA E KONTARES 52.490.66 € (pesdjetedymijekaterqindene dhjeteeuro e66/100 euro

Neni 3 Koha e përfundimit

3.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë në baze të urdheresës nga Organi Mbikqyres , Menaxheri i projektit

3.2. Punet duhet të kryehn sipas Planit dinamik të dhene në oferte 70 dite pune Nga Kërkesa në dosje të Tenderit që është e pajtuar nga O.E.

3.3. Vendi i kryerjes së Rruget sipas Projektit në Vandin Në lagje të qytetit

3.4. Mirembajtja e projektit pas dorzimit Do të jetë Obligim i punekryesit për periudhën 12 muaj.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të piuneve e janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet e njësive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Raport nga Menaxheri i Projektit dhe Menaxheri i kontratës me deshmi mbi punet e kryera , Fature dhe dokumente përcjellse të nevojshme

Keto pagesa do të behen me situacione në baze të kryerjeve të punimeve , Me raport nga organi mbikqyres në periudha të caktuara

Situacioni parë në vlerë 20000.00 euro

Situacioni dytë në vlerë 15.000.00 euro

Situacioni tretë në vlerë 12.241.60 euro

Dhe Pjesa finale – 5.249.07 €.Pas përmbylljes së Kontratës .Perkatesisht Pas Afatit të Mirembajtjes prej 12 muajeve pas Pranimit teknik të projektit , kjo mund të paguhet edhe me garancinë.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

Neni 7. Menaxhimi i Kontrates


7.1. Menaxher i projektit është : z. Lorenc Marleku nga Njesia Kerkuese .

7.2..Menxhimi i Kontrates . Bazuar ne neni 81 te LPP , Menaxhi i kontrtaes me vendim te ZKA do te jete :
_____ nga _____

7.3. Menaxher te kontrate snga O.E , jane Naser Kurtbogaj, Derisa Udheheqes i Punishtes Hazir Kuqi


7.3 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët **Shqipe** në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA KLINE

Emri:	ABAZ FONIQI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	28.06.2019
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve :

ALTICOM SHPK - KLINE

Emri:	ENVER KALLUDRA
Pozita:	PRONAR
Nënshkrimi:	
Data:	28.06.2019
Vula:	

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorpuar me referencë në të.
- 1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së drejtës së Ofruesit të Shërbimeve sigurveste të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur sigurvesti e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë e tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospective dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forcë Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar pasqyrimin e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasë ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e parapare në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtrohet një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës; (i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimin e kontratës; (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndër marrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumën që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pafektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike komizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marrë dhe do të ruajë, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurinë nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së leshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-në për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike komizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17**Kualiteti i Kontrollit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18**Përmirësimi i Defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasojë një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19**Konsekuencat e Shkeljes së kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20**Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e shihet të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <u>Lorenc Marleku nga Njesia kërkuese, Menaxher i projektit nga O.E. -</u>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është: 10 % vlerës së Plafikuar të kontratës, 5.249.07 € per Afatin e planit Dinamik 70+30 = 100 dite kalndarik
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës b) Përgjegjësia e pales së tretë 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës d) Përgjegjësia profesionale 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është gja tere kohes se Validitetit të Kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Do te përpiqet qe me pajtueshmëri te dy paleve te zgjidhen problemet .
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <u>Gjykata Themelore Peje – Dega Kline</u> në pajtim me ligjin në Kosovë, ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



PLANI PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS

Sipas Nenit 81.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042

Data e përgatitjes së PMK¹ 28.06.2019

Përgatitur nga: **vendos emrin dhe mbiemrin e Menaxherit të Projektit të AK-**
-DREJTOR I DREJTORISE SE URBANIZMIT

Numri i Prokurimit	634-19-2514-521NR. INTERN 634-19-034-521	
Titulli i Kontratës	NDERTIMI I KANALIZMIT LOT 4- LAGJE TE QYTETIT	
Punë/Shërbime/Furnizime	Viti Buxhetor	Emri dhe mbiemri i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit
FURNIZIM	2019	ABAZ FONIQI

Ngjarjet/Rezultatet e Kontratës	DETAJET E IMPLEMENTIMIT Afatet - 70 DITE PUNE VLERA 52.490.66€
Pjesët nën 'Detajat e Implementimit' në <i>italike</i> duhet të kompletohen dhe të bien dakord në mesë të palëve të kontratës para inicimit të implementimit të kontratës. PMK duhet të përtërihet gjatë implementimit të kontratës. Vendos Nuk Aplikohet për ato që nuk janë relevante	
I. Fillimi/ Mobilizimi i Kontratës	
Njoftimi për fillimin e punës/shërbimeve/furnizimit të mallrave	
Afati i përmbushjes	PLANI IMPLAEMTIMIT 70. DITE PUNE
Pranimi i garancisë së performancës dhe lirimi i sigurimit të tenderit	
Pranimi i garancisë së pagesës në avans,	SKA AVANS

¹ Plan i Menaxhimit të Kontratës është dokument i gjallë i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtuara në kontratën origjinale. Plan i Menaxhimit të Kontratës është i hapur për monitorim të KRPP-së gjatë implementimit të kontratës dhe të gjitha auditimeve tjera të kryera nga organet shtetërore. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

nëse është e aplikueshme	
Pagesa e avansit , nëse është e aplikueshme	SKA
Dorëzimet e para Shërbimet: raporti fillestarë Punët: instalimi i parë	
Shuma e dëmeve të likuiduara përfshirë kufizimin e dëmeve të likuiduara	
Periudha e përgjegjësisë për defekte	
II. Progresi i Kontratës	
Dorëzimet e Mëtutjeshme Shërbimet: raportet e progresit etj. Punët: instalimi i dytë etj.	Kontraktuesit në fazat e progresit të implementimit të kontratës]
Bisedimet e Rregullta, nëse është e aplikueshme	Vendos këtu planin e afatit kohorë kur do të ndodhin takime të parapara në vazhdimësi
Inspektimi i punëtorive, materialeve dhe vendeve të prodhimit	Specifikoni procesin e inspektimeve, të rregullta/ad hoc, dhe detajet e hulumtimeve të tilla.
Pagesat e përkohshme apo në faza, nëse është e aplikueshme	Specifikoni modalitetet e pagesave (në detaje) gjatë fazave të performimit të kontratës Pagesat konform kontrates pas pranimit të furnizimeve me fature dhe raport
Reduktimi i garancive, nëse është e aplikueshme	Ska avans
III. Përmbyllja e Kontratës	
Dorëzimet Finale Shërbimet: Raporti Final Punët: Përfundimi i Punëve	
Pranimi/ dorëzimi	
Pagesa e Fundit	
Fondet e mbajtura	
Skadimi i garancionit/periudha e përgjegjësisë	
Lirimi i garancisë	

Finalizimi i Planit të Menaxhimit të Kontratës²:

Në emër të Autoritetit Kontraktues ; KK KLINE – DREJTORIA URBANIZMIT – KLNE

Nënshkrimi: _____

Emri: **LORENC MARLEKU**


Pozita: **DREJTOR**

Data: _____

Në emër të [Kontraktuesit/Ofruesit të Shërbimeve -ALTICOM - KLINE

Emri: **ENVER KALLUDRA - PRONAR**

Nënshkrimi:



Pozita:

Menaxher

Data:

28.06.2019.

² Të nënshkruhet nga dy Menaxherët e Projektit